

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatori Ekonomik: Bajram Ha. Gashi B.I. me adresë në Suharekë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	04.08.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **01.08.2025**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Bajram Ha. Gashi B.I.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Rrethimi i oborreve të shkollave – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-25-2296-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-25-019-5-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. REFUZOHET** e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Bajram Ha. Gashi B.I.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Rrethimi i oborreve të shkollave – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-25-2296-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-25-019-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **29.07.2025**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II.** Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-25-2296-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-25-019-5-2-1**
- III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik: **Bajram Ha. Gashi B.I.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Rrethimi i oborreve të shkollave – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-25-2296-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-25-019-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **29.07.2025**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **01.08.2025**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza Ligjore për Refuzim të Kërkesës

Autoriteti Kontraktues: **Komuna e Rahovecit**, me datë: **29.07.2025** ne sistemin e prokurimit elektronik: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka publikuar: **B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES:**

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, **ANULON** aktivitetin e prokurimit:

Titulli i kontratës: **Rrethimi i oborreve të shkollave – Ritenderim**,

Nr. i prokurimit: **623-25-2296-5-2-1** & Nr. i brendshëm: **623-25-019-5-2-1**

Arsyetim: Tek Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve, në Nenin

3: SHQYRTIMI: *Kjo “Deklaratë e Nevojave dhe e Përcaktimit të Disponueshmërisë së Mjeteve” duhet të shqyrtohet nga personat e autorizuar për nënshkrim të kontratave para publikimit të B58 “Njoftimit mbi vendimin e AK-së” me qëllim që të ri konfirmojë se informatat financiare nuk kanë ndryshuar materialisht.*

Ndryshimet: Me arsyetim nga Zyrtar Kryesor Financiar, ka cekur: **Mjetet Financiare për këtë projekt janë paraparë të Sigurohen nga kodi buxhetor: 55185**

Ju njoftojmë se në këtë Kod Buxhetor, nuk ka mjetet buxhetore për shkak se janë shpenzuar nga përmbaruesi/thesari, si pasojë e kontratës kolektive. **Në mungesë të mjeteve buxhetore aktiviteti i prokurimit duhet te Anullohet**

Referoheni Deklaratës së Nevojave dhe e Përcaktimit të Disponueshmërisë së Mjeteve dhe Raporti i Analizave të Llogarive nga Thesari, të bashkangjitur në Sistemin e e-prokurimit, si **dokumenti shtojca.**

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me **24.03.2025** KOMUNA E RAHOVECIT, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Rrethimi i oborreve të shkollave – Ritenderim, me Numër të prokurimit: 623-25-2296-5-2-1, Numër i brendshëm: 623-25-019-5-2-1

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur, me llojin e kontratës punë, me vlerë të parashikuar të kontratës: **60,000.00 Euro.**

Me **08.05.2025**, AK: Komuna e Rahovecit, ka publikuar: B58 Njoftimin mbi Vendimin, ku ka shpërblyer me kontratë Operatori Ekonomik: AGE Group SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit

Me **13.05.2025** Operatori Ekonomik: BAJRAM HA.GASHI B.I., ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim

Më **14.05.2025** Autoriteti Kontraktues me VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës, e ka Refuzuar kërkesën e parashtruar nga Operatori Ekonomik.

Me **22.05.2025**, Operatori Ekonomik: BAJRAM HA.GASHI B.I, ka parashtruar Ankesë në OSHP me numër protokolli **2025/0390** lidhur me aktivitetin e prokurimit: Rrethimi i oborreve të shkollave – Ritenderim, me Numër të prokurimit: 623-25-2296-5-2-1, Numër i brendshëm: 623-25-019-5-2-1

Me **09.06.2025**, AK: Komuna e Rahovecit, ka pranuar Raportin e Ekspertit Shqyrtues të OSHP-së, Numër i lëndës: **2025/0390** lidhur me aktivitetin e prokurimit

Me **21.07.2025**, AK: Komuna e Rahovecit, ka pranuar Vendim të OSHP-së: **2025/0390** lidhur me aktivitetin e prokurimit, ku në pikën 2. të Vendimit thuhet: **Anulohet B58 Njoftim mbi Vendimin e AK të KUVENDI KOMUNAL – RAHOVEC**, ndërkaq aktiviteti i prokurimit: *Rrethimi i oborreve të shkollave – Ritenderim, me Numër të prokurimit: 623-25-2296-5-2-1 kthehet në Rivlerësim.*

Po ashtu në pikën 3. të Vendimit thuhet: *“Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.”*

Me **23.07.2025**, AK: Komuna e Rahovecit, e ka Njoftuar OSHP-në në bazë të Vendimit: **2025/0390** lidhur me aktivitetin e prokurimit, duke cekur: *Ne si Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, e kemi respektuar të gjitha pikat e këtij vendimi: Në attachment gjeni te bashkangjitur, **VENDIM - Për caktimin e komisionit për Rivlerësimin e ofertave - Rrethimi i oborreve të shkollave – Ritenderim** Komisioni Ri-Vlerësues do të bëjë Ri-vlerësimin e ofertave në afatet kohore në bazë të LPP-së;*

A r s y e t i m

Sipas Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik, në **Nenin 67.7** ceket: *Një vendim i OSHP-se për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.*

Gjatë Ri-Vlerësimit të aktivitetit të prokurimit edhe **para përgatitjes** së B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTU si dhe Letrat standarde për OE,
Ne si Zyre e Prokurimit kemi kërkuar nga ZKF-ja dhe ZKA-ja, të bëjnë **Shqyrtimin** e Deklaratës së Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve, ku në **Nenin 3** të kësaj Deklarate kërkohet: *“Deklaratë e Nevojave dhe e Përcaktimit të Disponueshmërisë së Mjeteve” duhet të shqyrtohet nga personat e autorizuar për nënshkrim të kontratave para publikimit të B58 “Njoftimit mbi vendimin e AK-së” me qëllim që të ri konfirmojë se informatat financiare nuk kanë ndryshuar materialisht.*

Me arsyetim nga **Zyrtar Kryesor Financiar**, ka cekur: **Mjetet Financiare për këtë projekt janë paraparë të Sigurohen nga kodi buxhetor: 55185**

Ju njoftojmë se në këtë Kod Buxhetor, nuk ka mjetet buxhetore për shkak se janë shpenzuar nga përmbartuesi/thesari, si pasojë e kontratës kolektive, duke e bashkangjitur Raportin nga **Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës (SIMFK)**, ku ju kemi informuar, duke cekur: **Referoheni Deklaratës së Nevojave dhe e Përcaktimit të Disponueshmërisë së Mjeteve dhe Raporti i Analizave të Llogarive nga Thesari, të bashkangjitur në Sistemin e e-prokurimit, si dokumenti shtojca.**

Në bazë të Fakteve dhe rrethanat procedurale, **Ankesa në OSHP** është dorëzuar me datë: **22.05.2025**, ndërsa me datë: **21.07.2025** është pranuar Vendim nga OSHP-ja: 2025/0390.

Mjetet e parapara me Buxhet, për këtë aktivitet të prokurimit janë nga kodi buxhetor: 55185, ku janë tërhequr nga Thesari sipas Vendimit Gjyqësor me datë: 02/06/2025

Shih Raportin nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës (SIMFK)

Republika e Kosovës

RAHOVEC

Raporti i Analizave të Llogarive - Detajet

Viti Fiskal : 2025

Periudha Fiskale : JANAR - KORRIK

Kriteret e filtrimit : Elementet hierarkike të Bllokut kodues - FUND : OBJ (Prej : 22) (Deri : 22) , ORG : UNIT (Prej : 623) (Deri : 623) , PROG : SPROG , OBJECT : SUBCL , PRQJ : S1PRQJ (Prej : 55185) (Deri : 55185)

Rendit sipas : Valutë - Bloku kodues; Bloku kodues - Bloku kodues

Grupa sipas : Valutë

Valutë : EURO (€)

Bloku kodues	Lloji i KD	Data e KD	Përfutjesi/Klienti/E mri i bankës	Obligim/Zotim	Prd.	Numri i kuponit të dritar	Origjina	Nmri i dokumentit burimor	Përshkrim	Debi	Kredi	Rec.	
OBJ / UNIT / SPROG / SUBCL / S1PRQJ													
22 - TË HYRAT VETANAKE NGA VITI I KALUAR											54,426.93	0.00	
623 - RAHOVEC											54,426.93	0.00	
93300 - ARSIMI FILLOR - RAHOVEC											54,426.93	0.00	
30 - PASURITË JOFINANCIARE											54,426.93	0.00	
55185 - RENOVIMET NE SHKOLLAT HAKI STERMILLI ZOQISHT, SKENDER KASTRA											54,426.93	0.00	
22/623/93300/34000/55185/0912	I regullit	2/6/2025	ZYRE PERMBARIMORE LEGAL A SHPK		QERS HOR	2025-381929	Kupon i shpenzimit	2025-189026	VENDIM GJYQESOR	3,008.27	0.00	Jo	
22/623/93300/34000/55185/0912	I regullit	2/6/2025	ZYRA PERMBARIMORE BK PARTNERS SH.P.K		QERS HOR	2025-381987	Kupon i shpenzimit	2025-189063	VENDIM GJYQESOR	51,418.66	0.00	Jo	
Totali për Valutë EURO (€)										54,426.93	0.00		
Totali për Valutë EURO (€) (Debi - Kredi)										54,426.93	0.00		

Për çështje të njëjta ka edhe Vendim nga OSHP, si p.sh. **VENDIMI OSHP: 2025/0386**;

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitive të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>